

Programi "Kurse para për kolegjin" e NYC Kids RISE Informacioni për ndryshimin e statusit të pjesëmarrjes dhe formulari për shkollat çarter

Rreth Programit "Kurse para për kolegjin"

Departamenti i Arsimit të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Education, DOE) ka bashkëpunuar me organizatën jofitimprurëse NYC Kids RISE, Inc. për Programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) ("Programi"). Përmes këtij programi pa pagesë, çdo fëmijë kopshti i regjistruar në Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut (NYC public school), duke përfshirë edhe shkollat çarter pjesëmarrëse, përfiton automatikisht në fillim një Llogari Burse Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) prej \$100 në emrin e tyre, përveç nëse prindërit ose kujdestarët e tyre zgjedhin të "mos marrin pjesë" në program. Familjet mund të fitojnë fonde shtesë burse në shpërblime për këtë llogari dhe komunitetet mund të kontribuojnë me fonde shtesë në Llogaritë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut për të treguar mbështetjen e tyre ndaj suksesit të çdo fëmije. Për më shumë informacion, vizitoni <http://nykidsrise.org/>.

Çfarë opsionesh kam si prind/kujdestar?

Veç nëse prindërit/kujdestarët zgjedhin të mos marrin pjesë duke "mos marrë pjesë" gjatë periudhës fillestare të kësaj zgjedhjeje, nxënësit e kualifikuar regjistrohen automatikisht në Programin "Kurse para për kolegjin". Megjithatë, prindërit/kujdestarët që zgjedhin të mos marrin pjesë, por më vonë ndërrojnë mendje dhe dëshirojnë që fëmija e tyre nxënës të marrë pjesë, mund të regjistrohen në një datë të mëvonshme. Gjithashtu, mund ta anuloni në çdo kohë pjesëmarrjen e fëmijës suaj në Program pas regjistrimit. Familjet kanë afat deri deri në fund të klasës së pestë të fëmijës së tyre për t'u regjistruar/ri-regjistruar.

Rreth anulimit

Prindërit/kujdestarët mund të zgjedhin të anulojnë në çdo kohë pjesëmarrjen e fëmijës së tyre në Programin "Kurse para për kolegjin". Pasi të dërgoni një Kërkesë për Anulim përmes këtij formulari, ju pranoni që NYC Kids RISE (1) të mbyllë Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) të fëmijës suaj nxënës, (2) të anulojë dhe t'i kthejë NYC Kids RISE të gjitha alokimet e fondeve për Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj nxënës, duke përfshirë shpërblimet dhe bursat komunitare që mund t'i jenë caktuar Llogarisë së Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj nxënës, (3) të fshijë çdo profil të Gjurmuesit të Kursimeve në emër të nxënësit, (4) të njoftojë çdo të rritur në skedar që ka lidhje me fëmijën tuaj nxënës për këtë fshirje dhe (5) të ruajë të dhënat historike që lidhen me llogarinë e fëmijës suaj nxënës dhe anulimin e saj në përputhje me politikën e anulimit të regjistrimit të NYC Kids RISE dhe ligjit në fuqi. Mbani parasysh: nëse zgjedhni të regjistroni sërish fëmijën tuaj në një datë të mëvonshme, alokimi për fëmijën tuaj gjatë ri-regjistrimit do të jetë vetëm \$100. Nuk do të përfshihet asnjë fondë shtesë që mund të jetë alokuar më parë.

Programi "Kurse para për kolegjin" e NYC Kids RISE Informacioni për ndryshimin e statusit të pjesëmarrjes dhe formulari për shkollat çarter

Rreth regjistrimit/ri-regjistrimit

Nëse në fillim prindërit/kujdestarët kanë zgjedhur të mos marrin pjesë, ose, gjatë kësaj kohe e kanë anuluar pjesëmarrjen e nxënësit në Programin "Kurse para për kolegjin", ata mund të kërkojnë në çdo kohë regjistrimin (ose ri-regjistrimin) e një nxënësi të kualifikuar në Program para përfundimit të klasës së pestë. Nëse nxënësi e ka mbaruar klasën e pestë, nxënësi **nuk** mund të bëhet pjesë e Programit, të marrë fonde burse apo të kualifikohet për shpërblimet e ardhshme.

Pasi të dërgoni kërkesën për regjistrim (ose ri-regjistrim) në Program, ju pranoni që DOE të ndajë informacionin vijues me NYC Kids RISE dhe partnerin e tyre të teknologjisë VistaShare. Ky informacion kërket për Llogarinë e Bursës Shkollore të Qytetit të Nju Jorkut për nxënësin e kualifikuar dhe Llogaria e Bursës Shkollore e Qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj nxënës (a) nuk do të krijohet derisa NYC Kids RISE ta marrë këtë informacion dhe (b) nuk do të alokohet shuma fillestare prej \$100 deri kur të zhvillohet cikli i radhës i zakonshëm i financimit të NYC Kids RISE (që aktualisht ndodh dy herë në vit):

- Numri i identifikimit të nxënësit, unik për programin
- Emri dhe mbiemri
- Data e lindjes
- Adresa e banimit nëse ndryshon
- Numri i telefonit të shtëpisë
- Emri i shkollës
- Niveli aktual i klasës
- Gjuha apo gjuhët e folura në shtëpi
- Nëse nxënësi është transferuar në ndonjë shkollë tjetër, brenda ose jashtë sistemit të shkollave publike të Qytetit të Nju Jorkut.

Edhe NYC Kids RISE dhe VistaShare i duhet informacioni vijues i të rriturit për deri në dy prindër/kujdestarë për nxënës:

- Numri i identifikimit të prindit, unik për programin
- Emri dhe mbiemri
- Adresa e emailit
- Numri i celularit dhe/ose ndonjë numër tjetër

Për të ndryshuar statusin e pjesëmarrjes së fëmijës suaj nxënës në Programin "Kurse para për kolegjin", plotësoni dhe dërgoni formularin në faqen 3 të zyrës qendrore të shkollës së fëmijës suaj nxënës.

Programi "Kurse para për kolegjin" e NYC Kids RISE Informacioni për ndryshimin e statusit të pjesëmarrjes dhe formulari për shkollat çarter

Formulari për ndryshimin e statusit të pjesëmarrjes

Si prind ose kujdestar i një nxënësi të kualifikuar, dua të ndryshoj statusin e pjesëmarrjes në Programin "Kurse para për kolegjin" të NYC Kids RISE.

Shënoni në kuti për ndryshimin që dëshironi të bëni?

- DUA TË REGJISTROJ nxënësin tim në Programin "Kurse para për kolegjin" të NYC Kids RISE. PRANOJ ndarjen e informacionit me NYC Kids RISE dhe partnerin e tij të teknologjisë, VistaShare. Kuptoj që Llogaria e Bursës Shkollore e Qytetit të Nju Jorkut të nxënësit nuk do të jetë menjëherë e disponueshme dhe do të krijohet gjatë ciklit të radhës të financimit, i cili aktualisht zhvillohet dy herë në vit.
- DUA TË ANULOJ pjesëmarrjen e nxënësit tim në Programin "Kurse para për kolegjin" të NYC Kids RISE. Kuptoj se paratë e alokuara për Llogarinë e Bursës Shkollore e Qytetit të Nju Jorkut të nxënësit tim në Programin "Kurse para për kolegjin" të NYC Kids RISE do të ricaktohet nga NYC Kids RISE për dobi të nxënësve të tjerë pjesëmarrës dhe se Llogaria e Bursës Shkollore e Qytetit të Nju Jorkut do të mbyllet.

Ofroni informacionin vijues para se t'ia dërgoni zyrës qendrore të shkollës së fëmijës suaj nxënës.

Emri dhe mbiemri i nxënësit:

Klasa zyrtare e nxënësit:

Emri i shkollës:

Emri i prindit/kujdestarit:

Firmat e prindit/kujdestarit:

Data:

SHËNIMI I ZYRËS: *Ky informacion në këtë dokument do të verifikohet dhe regjistrohet në ATS nga Mirëmbajtësi ATS (ATS Maintainer) i shkollës suaj brenda 7 ditëve nga marrja e tij (afërsisht 1 javë). Për pyetje në lidhje me Programin "Kurse para për kolegjin", kontaktoni ndërlidhësin e Programit "Kurse para për kolegjin" ose mund të telefononi linjën e ndihmës të Programit "Kurse para për kolegjin" në nr. (833) 543-7473. Mbani të gjithë Formularët e kthyer në Dosjen Kumulative (Cumulative Folder) të nxënësit për një kohë të pacaktuar.*